



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 32

Datë: 06. 07. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Shqyrtimi i mundësisë për vëzhgimin e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**
- 3. Të ndryshme.**

-
- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

Valdete Daka: A ka dikush vërejtje në agjendën e takimit ? Nuk ka, mirëpo, unë kisha dashur me shtuar që e kemi raportin e Auditimit të Brendshëm, e kemi në imell po nuk kemi komitet të auditimit, mirëpo duhet ta diskutojmë në një mbledhje të ardhshme...

Në vazhdim, mbasi që u vendos që raporti të diskutohet në agjendën e mbledhjes së ardhshme, anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Faleminderit, tani kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës!

2. Shqyrtimi i mundësisë për vëzhgimin e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Yll Buleshkaj: Sipas udhëzimit që kam pasur nga KQZ, kam vendosur kontakt me KSHZ të Maqedonisë dhe kam marrë informacionet e nevojshme. Nuk kemi kufizime, është vlerësimi yni se sa persona do të shkojmë t'i monitorojmë këto zgjedhje, sa kohë do të rrimë, veçse, duhet respektuar rregullat që i imponon Kovid...aspektet e tjera teknike, duhet t'i realizojmë sipas agjendës...

Ne, tha z. Buleshkaj, duhet të vendosim si, e qysh do të shkojmë. Pra, duhet të marrim vendim...

Valdete Daka: Po, duhet të vendosim! Unë, nuk mendoj të shkoj...arsyet dihen...

Sami Hamiti: Unë, gjykoj që anëtarët e ri duhet të shkojnë, një përvojë merret. Unë kam qenë, dhe nuk do të shkoj...

Alim Rama: Një përvojë merret, dhe është me rëndësi me i vëzhguar zgjedhjet... Së dyti, nuk dihet sa zgjatë pandemia. Kurse, ne do të kemi zgjedhje dhe është një përvojë e mirë se si organizohen zgjedhjet në pandemi..

Valdete Daka: Së pari, ta marrim një vendim sa persona do të shkojmë, dhe ta marrim një vendim...

Arianit Elshani: Pavarësisht qysh vendoset, unë për shkak të rrezikut nuk jam i interesuar të shkoj, kam arsytet, imapkti është aktual...

Valdete Daka: Arsyetja, qëndron vetëm te përvoja, përndryshe arsytet e tjera nuk janë favorizuese...

Në diskutim të mëtejshëm, morën pjesë: Arianit Elshani, Yll Buleshkaj, Čemailj Kurtiši, Valdete Daka dhe në fund, u vendos që të marrë pjesë një grup i reduktuar sa më i reduktuar...

Valdete Daka: Të mos zgjatemi në diskutime, kush është për pjesëmarrje ?

Anëtarët e KQZ, në parim morën vendim që të vëzhgohen këto zgjedhje.

Valdete Daka: Të marrim vendim se a do të shkojmë në mëngjes dhe të kthehemi në mbrëmje, apo do të rim më gjatë ?

Sami Kurteshi: Parimisht, jam që të shkojmë. Ka rrezik, mirëpo jam i interesuar të shkoj. Pra, mendoj të jemi në mëngjes dhe, gjatë ditës në ditën e zgjedhjeve, më 15 korrik...

Sami Hamiti: Për një ditë, nuk merret përvojë, duhet së paku një ditë më përpara, të shihet procesi, organizimi, shpërndarja e materialit...

Në diskutim, dhanë mendimet, gjykimet dhe propozimet e tyre: Alim Rama, Eshref Vishi, Arianit Elshani, Yll Buleshkaj.

Valdete Daka: Sa po kuptoj unë, mendimi është që të shkojmë me 14 – 16 korrik. Sa do të shkojmë nga KQZ ?

Sami Kurteshi, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniqi dhe Artan Asllani. Pra, pesë vetë nga KQZ dhe 4 nga Sekretariati.

Anëtarët e KQZ, morën vendim që nga data 14-16 korrik, të marrin pjesë 5 vetë nga KQZ dhe 4 nga Sekretariati.

Të ndryshme !

Valdete Daka: Sic thamë, për raportin e auditorit diskutojmë në një mbledhje të ardhshme, si dhe planin e veprimit për implementim e rekomandimeve të auditorit të jashtëm. Si dhe, t'i respektojmë sa të jetë e mundur masat e Qeverisë për covid...